

TV Klan, 20 prill 2005

Intervistë me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorin Pavel Vacek

Gazetare: Mimoza Koçiu

TV Klan: OSBE-ja është organizata që do të hartojë një raport mbi zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005. Nëse do të ketë shkelje si ato të vitit 2005, a do të konsiderohen këto zgjedhje përsëri të pranueshme?

Ambasadori Vacek: Për momentin, nuk do të doja të spekuloj me rezultatin e zgjedhjeve, si dhe me mënyrën se si do të mbahen ato. Ato, sigurisht, do të monitorohen dhe, konkretisht, do jetë misioni i OSBE/ODIHR-it që do t'i monitorojë dhe do të raportojë mbi mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve. Ajo që mund të them me siguri është se ne kemi bërë më të mirën e mundshme për të ndihmuar përfaqësuesit politikë shqiptarë dhe administratën shqiptare për krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të mira. Ne do të vazhdojmë t'iu ofrojmë ndihmë autoriteteve shqiptare si në përgatitjen ashtu edhe në mbajtjen e zgjedhjeve. Përsa i përket rezultatit të tyre, kjo do të jetë plotësisht në duart e përfaqësuesve politikë shqiptarë e zgjedhësve shqiptarë. Ajo që mund të them, gjithashtu, është që të shpresojmë që rezultati i këtyre zgjedhjeve të vendoset nga zgjedhësit shqiptarë.

TV Klan: Pak ditë më parë, Ambasadori Saltzmann shprehu shqetësimin e Komisionit Evropian lidhur me disa njerëz të lidhur ngushtë me interesa të mëdha ekonomike dhe krimin që do të kandidojnë për deputetë në zgjedhjet e ardhshme. A e ndani edhe ju këtë shqetësim me të?

Ambasadori Vacek: Sigurisht që ne jemi në dijeni të këtij shqetësimi, sepse shqetësime të tilla vijnë kryesisht nga brenda skenës politike shqiptare dhe unë besoj që kjo është e ligjshme, ashtu sikurse është e ligjshme që probleme të tilla të trajtohen nëpërmjet mjeteve të posaçme që janë në dispozicion të politikanëve shqiptarë, si për shembull, komisionit parlamentar për monitorimin e përgatitjeve për zgjedhjet. Dhe në qoftë se ka një vullnet për t'iu trajtuar këto çështje, ka edhe zgjidhje. Diçka tjetër që do të përmendja është edhe kodi i sjelljes i propozuar nga Presidenti. Ajo që është e rëndësishme këtu është që i takon partive politike shqiptare të merren me to, si dhe zgjedhësve shqiptarë të krijojnë opinionet e tyre lidhur me atë se sa partitë politike shqiptare janë të afta të përmbushin angazhimet e tyre në lidhje me Kodin Zgjedhor dhe se si partitë i realizojnë angazhimet e tyre përmes kodit të sjelljes. Dhe kjo është një nga çështjet që ia vlen të trajtohet në kodin e sjelljes.

TV Klan: Partia Socialiste dhe koalicioni i majtë po përgatiten për të dalë me një skemë bashkëpunimi sipas së cilës partitë e vogla aleate mund të përfitojnë nga lista proporcionale. A mendoni se kjo skemë mund të ndikojë në vullnetin e lirë të votuesve?

Ambasadori Vacek: Së pari, ne ende nuk dimë mjaftueshëm për çfarëdolloj marrëveshjeje që mund të jetë marrë në konsideratë apo propozuar. Ne, sigurisht, jemi të interesuar për praktika të tilla dhe mund të them që ODIHR-i, si një institucion që merret me zgjedhjet, do të jetë në gjendje që t'i shohë këto praktika më konkretisht, por, megjithatë, përgjegjësia dhe përgjegjshmëria kryesore i takon partive politike dhe zgjedhësve shqiptarë. Është e vështirë të flasësh për gjëra që janë komentuar vetëm në media. Dhe pa dyshim, ajo që do të duhet të respektohet është Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor. Ky do të jetë edhe qëndrimi ynë dhe i institucioneve të tjera ndërkombëtare të interesuara për përgatitjen e rregullt të zhvillimit të zgjedhjeve.

TV Klan: A mendoni se atë që ne e quajmë si fenomeni i Dushkut mund të përsëritet, domethënë, dalja e një numri rekord deputetësh nga një zonë e vogël zgjedhore?

Ambasadori Vacek: Në fakt, ajo që mendoj unë nuk është shumë e rëndësishme. E rëndësishme është që kësaj pyetjeje t'i përgjigjen ose kjo pyetje t'iu drejtohet atyre që marrin në konsideratë apo propozojnë të tilla sisteme. Për aq kohë sa unë nuk kam informacione konkrete lidhur me atë që është propozuar, nga kush është propozuar dhe si konkretisht, unë, sinqerisht, nuk mund të them ndonjë gjë.

TV Klan: Çfarë mendoni për propozimin e Berishës që çdo votë për kandidatin të shkojë automatikisht tek partia që ai/ajo përfaqëson në sistemin proporcional, një propozim ky që është nxitur shumë nga opozita?

Ambasadori Vacek: Të them të drejtën, nuk mund të jap një gjykim lidhur me këtë. Sigurisht që kemi lexuar për këtë, por nuk është qëllimi ynë të komentojmë mbi çdo propozim të bërë, dhe, përsëri e theksoj se, nëse do të kishte ndonjë mundësi për diskutimin e tij nga aktorët politikë shqiptarë, kjo do të ishte një gjë e mirë. Ajo që, sigurisht, duhet marrë në konsideratë është se sa në përputhje janë këto propozime me Kodin Zgjedhor të ndryshuar së fundi.

TV Klan: Lidhur me Kodin Zgjedhor, a ishin negociatat mbi amendimin e tij të vështira dhe cilët ishin politikanët më të vështirë në lidhje me këto negociata?

Ambasadori Vacek: Kjo është një pyetje e vështirë. Nuk i takon atij që luan rolin e një lehtësuesi apo të një ndërmjetësuesi në një proces të zbulojë detaje të bisedimeve apo gjykime personale lidhur me ndonjë person konkret. Kjo nuk do të ishte etike nga ana ime. Kështu që, unë nuk mund ta bëj këtë.

TV Klan: Le ta shohim Z. Ambasador nga një kënd tjetër, në planin personal. Përveç rolit tuaj si Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si e kaloni ditën e lirë këtu në Shqipëri? Cila do të ishte një ditë e juaja tipike këtu?

Ambasadori Vacek: Një ditë tipike pune? Kjo është shumë e thjeshtë për ta përshkruar. Ndërsa ditët e pushimit kufizohen vetëm tek fundjavat, dhe jo të gjitha ato. Në kohën e lirë, merrem me sporte. Kam disa të preferuara që i praktikoj. Dhe nëse merrem me sport,

kjo do të thotë që shkoj jashtë Tiranës dhe, madje, edhe jashtë vendit. Sportet e mia të preferuara janë të bëj ski dhe sërfinj.

TV Klan: A ka ndonjë gjë që ju zbavit dhe cilat janë marrëdhëniet tuaja me shqiptarët?

Ambasadori Vacek: Shqiptarët janë, në përgjithësi, njerëz miqësorë dhe mikpritës ndaj të huajve dhe vizitorëve që vijnë këtu, ashtu siç kanë qenë edhe mua.

TV Klan: Sa dini për Shqipërinë, qytetet shqiptare dhe a keni ndonjë qytet të preferuar këtu?

Ambasadori Vacek: Në fakt, nuk di shumë për Shqipërinë e qytetet shqiptare. Kjo është një mangësi e imja që do më duhet ta kompensoj. Përveç Tiranës, ku unë punoj, shkoj edhe në Vlorë, për shembull, por kjo nuk do të thotë se ai është vendi më i bukur këtu. Nuk mund ta them këtë, por, në Vlorë, shkoj shpesh.

TV Klan: Pyetja e fundit së cilës edhe mund të mos i përgjigjeni. Nëse do t'ju duhëj të bënit një vlerësim të punës suaj, ose të vlerësonit se sa ndiheni i realizuar në misionin tuaj këtu në një shkallë nga njëshi tek dhjeta, çfarë note do t'i vinit vetes?

Ambasadori Vacek: Pyetje e vështirë kjo. Për momentin, nuk më duket sikur di mjaftueshëm apo të gjitha gjërat për të vënë një notë. Gjithashtu, nuk është roli ynë ky. Unë nuk jam këtu për të etiketuar gjëra apo njerëz, apo për të vënë nota, ne jemi këtu për të ndihmuar.